

Ku mund të ankoheni se nuk është përdorur përkthyes në shërbimin shëndetësor?

Fylkeslegen ved Helsetilsynet (Shefi i mjekësisë në prefekturën) ku banoni (www.helsetilsynet.no)

Pasient- og brukerombudet (Ombudsmani për pacientë dhe klientë) në prefekturën ku banoni (www.pasientogbrukerombudet.no)

Sivilombudsmannen (Ombudsmani për të drejta qytetare), telefoni 22 82 85 00
Numri falas (+47)800 800 39

Likestillings- og diskrimineringsombudet (Ombudsmani për barazi dhe diskriminim), telefoni: 24 05 59 50

Organisasjonen mot Offentlig Diskriminering (Organizata Kundër Diskriminimit Publik) (OMOD), telefoni 22 20 87 37, www.omod.no

A keni pyetje mbi të drejtat Tuaja?

Pasient- og brukerombudet (Ombudsmani për pacientë dhe klientë) në prefekturën ku banoni (www.pasientogbrukerombudet.no)

Organisasjonen Mot Offentlig Diskriminering (OMOD), telefoni 22 20 87 37, www.omod.no

A keni ankesa në lidhje me kualitetin dhe me kualifikimin e përkthyesit?

Ankesat mund të bëhen në institucionin ku jeni pacient.

Legjislacioni mbi të drejtat e pacientëve dhe mbi detyrat e personelit shëndetësor

Lov om pasientrettigheter (Ligji mbi të drejtat e pacientëve)

Lov om helsepersonell (Ligji mbi personelin shëndetësor)

Kjo broshurë gjindet në më tepër se 20 gjuhë të ndryshme dhe mund të nxirret nga interneti në adresat:

www.nakmi.no

www.helsedirektoratet.no



Pacienti dhe përkthyesi

Një broshurë mbi përkthyesin
në shërbimin shëndetësor

PACIENTËT DHE PËRKTHIMI

- Informacionet që merrni mbi gjendjen Tuaj shëndetësore dhe mbi trajtimin duhet të jepen në një gjuhë që Ju kuptoni.
- Porositja e përkthyesit është detyra dhe përgjegësia e shërbimit shëndetësor.
- Shërbimi i përkthimit është falas për pacientin.
- Mund ta lajmëroni shërbimin shëndetësor përmes telefonit për të kërkuar porositjen e përkthyesit.
- Keni të drejtë që të keni përkthyes edhe kur Ju vet folni norvegjisht në jetën e përditshme. Kjo vlen sidomos në raste të sëmundjeve serioze dhe kronike, si dhe në raste bisede mbi vuajtje psikike.
- Vetëm përkthyesit e kualifikuar mund të përdoren si përkthyes.
- Fëmijët nuk duhet të përdoren si përkthyes.
- Personeli shëndetësor është përgjegjës për dhënjen e ndihmës shëndetësore në një mënyrë të arsyeshme. Nëse Ju vet nuk doni të keni përkthyes, duhet të Ju informojnë mbi mundësinë që kjo mund të ketë pasoja negative për shëndetin Tuaj.
- Përkthimi përmes telefonit mund të jetë një alternativë e dobishme në vend të përkthyesit të pranishëm.
- Në qoftë se nuk mund të paraqiteni në kohën e caktuar duhet të lajmëroheni 24 orë më herët. Në rast të kundërt duhet të paguani çmimin e konsultimit.

SI MUND TË PËRFITONI SA MË TEPËR NGA NJË BISEDË ME PËRKTHIM?

- Duhet ti tregoni saktësisht shërbimit shëndetësor se cilën gjuhë folni. Në raste kur anëtarë të ndryshëm të familjes marrin pjesë në konsultimin, duhet të porositet një përkthyes që kuptohet nga të gjithë.
- Paraqituni në kohën e caktuar.
- Planifikoni se mbi cilën temë dëshironi të folni gjatë konsultimit shëndetësor.
- Folni me fjali të shkurta dhe mos folni tepër gjatë. Atëherë përkthyesi do të ketë mundësi të përkthejë atë që flitet në mënyrë korrekte.

Ç'ËSHTË PËRKTHYESI DHE CILAT JANË DETYRAT E TIJ/E SAJ?

- Një përkthyes i aftë i kualifikuar është i shkolluar si përkthyes dhe ka përvojë në përkthim.
- Në fillim të bisedës përkthyesi tregon në të dy gjuhët rregullat e përkthimit.
- Përkthyesi nuk merr anën e asnjërës palë gjatë bisedës.
- Përkthyesi ka detyrimin e ruajtjes së sekretit profesional. Shkelja e kësaj detyre është vepër e ndëshkueshme.
- Një përkthyes duhet të përkthejë çdo gjë që thuhet gjatë bisedës por nuk mund të japë këshilla dhe të shtojë mendimet e veta.
- Një përkthyes duhet të mirret vetëm me përkthimin dhe nuk mund të marrë përsipër detyra tjera, as për pacientin dhe as për personelin shëndetësor.
- Mos e ndërpreni përkthyesin, duhet t'i jepni kohë që të përkthejë atë që thuajnë palët e bisedës.
- Gjithë pyetjet duhet t'i drejtohen personelit shëndetësor, jo përkthyesit.